



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
KËSHILLI DREJTUES**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, _____.____.2022

VENDIM

Nr. _____, datë _____.____.2022

PËR

**AUTORIZIMIN E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM PËR FILLIMIN E
PROCEDURAVE PËR PËRZGJEDHJEN E SUBJEKTIT MBËSHTETËS PËR
MIRËMBAJTJEN E SISTEMIT INFORMATIK PËR RAPORTIM DHE
KOMPENSIM NË AGJENCINË E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE**

Në bazë dhe në zbatim të nenit 26, pikat 4 dhe 5, të nenit 42 pika 7, të nenit 43, pika 1, shkonja “ç”, të nenit 44 pika 2 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave“, i ndryshuar, të nenit 6, nenit 9, nenit 22, pika 3, nenit 27 pikat 1, 2 dhe 3 dhe nenit 28 të Rregullores “Për kompensimin e depozitave të siguruar” të miratuar me Urdhër të Guvernatorit nr. 3762, datë 18.7.2016, si dhe të nenit 18, pika 2 të Rregullores të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

V E N D O S I:

1. Të autorizojë Drejtorin e Përgjithshëm për fillimin e procedurave për përzgjedhjen e subjektit mbështetës për mirëmbajtjen e Sistemit Informatik për Raportim dhe Kompensim në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave për një periudhë kontraktore një vjeçare.
2. Të miratojë fondin limit prej 4,283,500 (katër milionë e dyqind e tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind) lekë pa TVSH për përzgjedhjen e subjektit mbështetës për ofrimin e shërbimit me objekt “Mirëmbajtja e Sistemit Informatik për Raportim dhe Kompensim, në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave, për një periudhë kontraktore një vjeçare”.
3. Efektet financiare në zbatim të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Agjencisë.





4. Ngarkohen Drejtori i Përgjithshëm dhe Sektori i Teknologjisë së Informacionit me zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Shqipe Malaj

Sekretare

Donald Duraj

Kryetar



